

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NIK CONSULTING” sh.p.k

Sot në Tiranë, më 21.02.2024, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, i ndryshuar, ne:

1) **Z. Gergji DHEMBI**, atësia Nik, shtetas shqiptar, lindur në Pogradec, më 22.04.1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I10422044H,

dhe

2) **Znj. Elsandra DHEMBI**, atësia Pandush, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 25.09.1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I35925056P.

Me vullnet të lirë e të plotë vendosim të themelojmë dhe krijojmë Shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur **“NIK CONSULTING” sh.p.k**.

Neni 1
Emërtimi

Në kuptim të këtij Akt - Themelimi , Ortak të kësaj Shoqërie janë:

1) **Z. Gergji DHEMBI**, atësia Nik, shtetas shqiptar, lindur në Pogradec, më 22.04.1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I10422044H,

dhe

2) **Znj. Elsandra DHEMBI**, atësia Pandush, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 25.09.1983, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I35925056P.

Neni 2
Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do jetë si në vijim:

“Aktivitete në fushën e konsulencës në biznes të shoqërive kombëtare dhe të huaja që dëshirojnë të investojnë ose të shtrijnë aktivitetin e tyre tregtar në Shqipëri. Hoteleri, agriturizëm, restorante si dhe prodhim produktesh ushqimore. Import eksport mallrash te ndryshem për nevojat e vetë shoqërisë dhe për të tretët. Aktivitete në sektorin e ndërtimit, rikonstrukcionit të veprave publike dhe private, mirëmbajtje të pasurive të paluajtshme publike dhe private. Prokurime publike. Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike. Agjensi imobiliare, studime tregu komëbar e ndërkombëtar, komisioner dhe agjensi për të tretët. Ndërtim i objekteve civile dhe industriale, ndërtimi i ndërtimesave, zyrave, veprave energetikë dhe çdo vepre tjetër me qëllim ndërtimi duke përfshirë restaurimin dhe riparimin e këtyre veprave. Import, eksport dhe tregtimi me shumicë e



pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë, apo të tretëve të materialeve te ndryshëm, atyre të ndërtimit, produkteve ushqimore dhe industriale, makinerive, pajisjeve e pjesëve të tyre të këmbimit, lendeve të para, produkteve të gatshme e gjysëm të gatshme. Shitje me shumicë dhe pakicë mallrash te ndryshem si edhe import, eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i tyre. Transport kombëtar e ndërkombëtar në rrugë detare, tokësore, apo ajrore të materialeve të ndryshëm. Konsulencë dhe ndërmjetësim për pasuri të paluajtshme, lidhje dhe zbatim kontratasht, marrëveshjesh të ndryshme, ortakërish, shoqërishë të përbashkëta apo forma të tjera, veprimtari komisionere, përfaqësimi, si dhe veprime të tjera të porositura nga palët e treta të lejuara nga legjislativi shqiptar. Konsulencë, revizion, ekspertizë, vlerësimë të kapitaleve dhe gjendjes së shoqërive, planbiznese, projekte zhvillimi dhe studime të efektiviteteve ekonomike, përcaktimi i prioriteteve në fusha të ndryshme të ekonomisë etj, administrim fondesh dhe/ose investimesh etj. Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukturës dhe/ose të pjesëve përbërëse të saj. Tregtimin, dhënien e marrjen me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të veta ose të tretëve, edhe te mobiluara, transaksione në burse, shitblerje lettrash me vlerë. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare dhe qiramarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe të shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Në fushën e Real Estate shoqëria do të kryejë ndermjetesim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitje, blerje të tyre, për vete dhe për të tretët. Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të huaja dhe me degët e tyre të mundshme në Shqipëri. Kryerja e shërbimeve të tregimit online të produkteve të ndryshme për vete dhe per te tretet. Realizimi, dizajni Software dhe Hardware. Dizajnim website për vete dhe për të tretë. Mirëmbajtje e websiteve për vete dhe për të tretë. Krijim dhe menaxhim i platformave reklamuese për vete dhe për të tretët. Marketing online. Tregtim me shumicë dhe pakicë i produkteve Software dhe Hardware. Realizimi i impianteve elektrike dhe rrjeteve kompjuterike. Gjithashtu, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj shërbimi apo aktiviteti, ndërtimi, sipërmarrje, nënkontraktimi, zbatimi, imobiliare, tregtar, finansiar, konsulencë, qiradhënie apo dorëzanie, etj., që i lejohet një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj”.

Neni 3

Selia

3.1 Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në adresën **Tiranë, Dobresh, pasuria nr. 324/4/1, Z.K. 1498, Vol. 1, Faqe 132.**

3.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në respekt të parashikimeve ligjore ne fuqi si edhe të Statutit, përvëç aktivitetit në nivel lokal, do të mund të hapen dhe të mbyllen seli dytësore, stabilimente, filiale, zyra përfaqësimi, agjensi dhe adresa brenda dhe jashtë territorit Shqiptar.

3.3 Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

Neni 5 Kapitali

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

5.2 Pjesëmarrja e Ortakëve Themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

Nr.	Emri	Numri i kuotave	Pjesëmarrja në përqindje (%)	Vlera totale e kontributit (Lekë)
1.	Z. Gjergji DHEMBI	1	50%	50.000
2.	Znj. Elsandra DHEMBI	1	50%	50.000

Neni 6
Emërimi i Administratorit

Emërohet Administrator i Vetëm për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga dita e regjistrimit të Shoqërisë, **Z. Gjergji DHEMBI**, atësia Nik, shtetas shqiptar, lindur në Pogradec, më 22.04.1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal I10422044H.

Neni 7
Legjislacioni i referimit

Për gjithçka nuk është parashikuar nga ky Akt-Themelimi do t'i bëhet referim legjislacionit shqiptar në fuqi në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kompetencë ekskluzive mbi të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Ortakëve dhe organeve të vetë Shoqërisë do të ketë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 9
Vula e Shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 10
Gjuha e Akt - Themelimit

Ky Akt - Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipëtare.


Neni 11
Dispozita të fundit

11.1 Shoqëria "NIK CONSULTING" sh.p.k." sh.p.k. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe të këtij Akt - Themelimi.

11.2 Ky Akt - Themelimi nënshkruhet nga Ortakët Themelues më datë 21.02.2024 pasi është lexuar, kuptuar dhe konform vullnetit të shprehur të tyre.

ORTAKËT THEMELUES

z. Gjergji DHEMBI



znj. Elsandra DHEMBI

